



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: Cengiz Begoli B.I
Emri Tregtar: N.SH. "Kent Media"
NUI: 810913352
Pronari: Cengiz BEGOLI
OSHMA: Radio Kent FM 2
Adresa: Rr/Bajram Kelmendi,
Blloku A, Lokali 6/1, Prishtinë

Emri i Biznesit: "Klan Kosova" SH.P.K.
NUI: 810795297
Pronari: KGO Media Investments Holding SH.P.K.
NUI: 811575804
Pronari: KGO Media Investments DOOEL
Pronari: Kushtrim GOJANI
Adresa: Rr/ Zona Industriale, ish Fabrika
Amortizatorëve Prishtinë

VENDIM

për refuzim të kërkesës për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së programore, gjuhës së transmetimit, emrit të radios si dhe kategorisë së licencës të Radio Kent FM 2, me seli në Komunën e Mamushës



Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Kent FM 2 është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësorë të programeve të radios në gjuhën turke, në komunën e Mamushës. KPM me vendimin e datës 25 mars 2015, i ka lëshuar licencën Radio Kent FM 2 për një afat prej shtatë (7) vitesh.
3. Më datën 22 tetor 2021, Radio Kent FM 2 ka dorëzuar në zyrën e KPM-së një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio Kent FM 2 nga biznesi individual Cengiz Begoli B.I., emri tregtar N.SH. Kent Media, me Numër Unik Identifikues (NUI) 810913352 dhe me pronar z. Cengiz Begoli tek biznesi Klan Kosova SH.P.K., me Numër Unik Identifikues - 810795297, me pronar personin juridik KGO Media Investments Holding SH.P.K. me Numër Unik Identifikues - 811575804, ndërsa ky biznes me pronar si person juridik KGO Media Investments DOOEL, EMBS - 7115326, me seli në Shkup dhe me personin fizik si pronar z. Kushtrim Gojani.

4. Gjithashtu, me anë të së njëjtës kërkesë, nga kandidati për pronar të ri, është kërkuar edhe aprovimin i KPM-së për ndryshimin e emrit nga Radio Kent FM 2 në Radio Klan Kosova FM, ndryshimi i skemës programore dhe gjuhës së transmetimit si dhe ndryshimi i kategorisë së licencës nga lokale në atë regjionale.

Arsyetim


5. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
6. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
7. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
8. Në kërkesën për ndryshimin e pronësisë, pronari aktual i Radio Kent FM 2 ka deklaruar se arsye për këtë ndryshim janë vështirësitë financiare të shkaktuara nga situata me pandeminë Covid 19, për arsye se me fillimin e pandemisë bizneset i kanë ndalur reklamën.
9. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të Radio Kent FM 2 përmes një deklarate me shkrim, ka shprehur gatishmëri që ofrimin e shërbimeve mediale audio për publikun do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
10. Komisioni konstaton se, paraprakisht Radio Kent FM 2 nuk ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM-së.
11. Komisioni vlerëson se, kërkesa për ndryshim të pronësisë Radio Kent FM 2 nuk është e kompletuar me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ngase mungon dëshmia nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).
12. Komisioni vlerëson se natyra e licencës së kësaj radio është specifike e cila është lëshuar përmes konkursit publik të shpallur nga KPM, i cili konkurs ka marrë parasysh nevojat e banorëve të komunës së Mamushës, ku shumica e tyre i përkasin komunitetit turk dhe është e destinuar si radio që ti shërbejë dhe ti plotësojë nevojat këtij komuniteti, për informim dhe argëtim në gjuhën e tyre amtare.
13. Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë dhe bartjes së licencës së Radio Kent FM 2, kërkesës për ndryshimin e emrit, skemës programore, gjuhës së transmetimit dhe ndryshimin e kategorisë së licencës nga lokale në atë regjionale, sipas kërkesës, nuk është në interes të publikut, respektivisht të qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët jetojnë në komunën e Mamushës dhe si e tillë kërkesa nuk i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

14. Komisionit në takimin e tij të mbajtur më datën 16 nëntor 2021, merr vendim për refuzimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio Kent FM 2 sipas kërkesës, duke u bazuar në specifikat e kësaj radio dhe qëllimin e lëshimit të kësaj licence për ti shërbyer qytetarëve të Republikës së Kosovës, të komunitetit turk në komunën e Mamushës dhe në plotësimin e nevojave të këtij komuniteti për informim dhe argëtim në gjuhën e tyre amtare, si dhe refuzimin e kërkesës për ndryshimin e emrit, skemës programore, gjuhës së transmetimit dhe ndryshimin e kategorisë së licencës nga lokale në atë regjionale.

E drejta për Ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
17. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



25.11.2021

datë